

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Graçanicës z. Bojan Sojanoviç**

I nderuari z. Sojanoviç,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin tuaj të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Investime në rrugë dhe parkingje, shkolla dhe çerdhe;
- Zhvillim ekonomik;
- Përpilimin e planit të fizibilitetit me qëllim të punësimit të të rinjve;
- Formimin e Këshillit Ekonomik i cili do të bashkëpunoj me firmat e Kosovës dhe më gjerë për të gjetur mundësinë më të mirë për investime ekonomike dhe gjenerimin e vendeve të punës;
- Zvogëlimin e numrit të vjedhjeve;
- Ndërtimin e një spitali me vlerë prej 1 milion euro;
- Zhvillimin e Kooperativës Bujqësore;
- Renovimin dhe ndërtimin e qendrave të reja sportive;
- Ndërtimin e shtëpisë së gjuetarëve në Llapnasellë;
- Zgjedhja e problemit të rrymës duke ngritur vetëdijesimin/inkurajimin e popullatës për pagesën e rrymës.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)